



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljepra / Priljepra Received / Delivery	08 - 11 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org. Unit	Nr. Prot Bil. Prot Prot. No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6914/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 589/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, dhe anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 589/2021, të datës 24.06.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë

sipas Aktgjykimit A.nr. 1980/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "mase disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.589/2021 e datës 24.06.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET masa disiplinore paralajmërim (qortim) me shkrim e datës 18.06.2021 e shqiptuar ndaj ankueses.
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi. që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e tij, duke e hequr masën disiplinore nga dosja e ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesja me datë 24.06.2021, me numër protokoli 3297/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore së Drejtori Rajonal, më datë 18.06.2021 i ka shqiptuar masë disiplinore paralajmërim (qortim) me shkrim me arsyetimin se *për mos respektim të detyrave të deleguara përmes emailit zyrtar, të cilat detyra kanë qenë me afat të caktuar, me çka është bërë shkelje ligjore për mos respektim të detyrës zyrtare.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 30.06.2021, me numër protokoli 3380/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa me datë 27.07.2021 me numër protokoli 3917/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.08.2021 me numër protokoli 4113/2021, ka njoftuar ankuesen se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A.nr.589/2021, të datës 24.06.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 06.08.2021, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 16.09.2022, A. Nr. 1980/2021, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 06.08.2021, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A. Nr.589/2021, të datës 24.06.2021 të ankueses Suzana Musliu.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.589/2021 e datës 24.06.2021, me numër protokoli 3297/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Aktgjykimi A. Nr. 1980/2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Paralajmërimi (qortim) me shkrim; Konkluzioni i datës 29.10.2015; Vendimi i datës 30.05.2019, i Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 13.01.2012; e-maili i datës 15.06.2021; e-maili i datës 17.06.2021; Njoftimi i datës 06.08.2021, i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 06.08.2021, me numër protokoli 4113/2021, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e bazuar, sepse:**

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesja pretendon se masa disiplinore është tendencioze dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji pasi ka shqyrtuar pretendimin e ankueses, ka konstatuar se Udhëheqësi më datë 17.06.2021 një numër të caktuar të zyrtarëve të ATK-së u ka dërguar imell zyrtar në orën 16:27 dhe ka caktuar disa detyra ku duhen të kryhen, ndërsa ankuesja sipas imellit të datës 17.06.2021 ka njoftuar Udhëheqësin e saj se nga data 18.06.2021 është në pushim vjetor dhe në të njëjtën kohë ka njoftuar se cilët inspektor do ta zëvendësoj gjatë ditëve të pushimit, prandaj nuk qëndron konstatimi i Udhëqësit të ankueses se nuk ka njoftuar se kush do ta zëvendësoj dhe ankuesja nga pushimi nuk ka mundur ti përfundoj detyrat, gjithashtu pushimi i ankueses ka qenë i aprovuar në mënyrë të rregullt.

Kolegji po ashtu, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe masës disiplinore paralajmërim (qortim) me shkrim të shqiptuar ndaj ankueses, i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit". Ndërlidhur me këtë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë kualifikuar shkeljet e rënda të detyrave të punës: "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë". Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar".*

Andaj gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë të masës disiplinore paralajmërim (qortim) me shkrim të datës 18.06.2021 të shqiptuar ndaj ankueses, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që masa i është shqiptuar për shkak të mosrespektimit të afateve për përfundimin e detyrave zyrtare, si rrjedhojë mos përmbushja e detyrave të punës respektivisht mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, konsiderohen shkelje të rënda të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses shkeljen e ankueses e ka cilësuar vetëm që është shkelje e sanksionuar me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pa e cilësuar se a përbën shkelje të lehtë apo shkelje të rënda, rrjedhimisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses nuk ka vlerësuar drejtë

natyrën e shkeljes së supozuar nga ana e ankueses, mbi këtë bazë inicimi i kësaj procedure ndaj ankueses është bërë në kundërshtime me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht nenin 47, ka paraparë se cilat masa mund të zbatohet ndaj nëpunësit civil, rrjedhimisht i ka ndajë në: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*, si rezultat i kësaj ky ligj nuk parasheh llojin e masës disiplinore të shqiptuar ndaj ankueses.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se për shkelej të rënda kompetent për të shqiptuar masën disiplinore është komisioni disiplinor ndërsa për shkelje të lehta kompetent për të shqiptuar masa është mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil, në rastin konkret të ankueses, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë sipas cilësimit të shkeljes nënkuptohet që ankuesja ka kryer shkelje të rënda ndërsa masën e ka shqiptuar në kundërshtim nenin 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Nga të lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për shkak të shkeljeve procedurale në këtë procedurë disiplinore është lëshuar në shkelje materiale, gjegjësisht nuk është lëshuar në atë nëse ankuesja ka bërë shkelje të disiplinore, si rezultat i kësaj, për shkak të këtyre rrethanave, Kolegji konstaton që masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe e njëjtë është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, janë të obliguar që bëjnë heqjen e masës disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e saj sipas këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
LËNDA, A.NR. 589/2021**



**Rushit KAJTAZI**  
Procesmbajtës

**Vendimi i dërgohet:**

Ankueses

Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;

Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;

Arkivit të KPMSHCK-së,